




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL



KGJK.nr.62/2024

Datë: 7 mars 2024

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS (KGJK), në bazë të nenit 108 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 7 paragrafi 1 pika 1.16 të Ligjit Nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, si dhe nenit 11 paragrafi 4 i Rregullores Nr.02/2020 për organizimin dhe veprimtarinë e brendshme të Gjykatave të Republikës së Kosovës, në takimin 322-të, të mbajtur më 7 mars 2024, nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. I kërkohet kryetarit të Gjykatës së Apelit dhe menaxhmentit të gjykatës që të hartojnë planin konkret lidhur me rishpërndarjen dhe balancimin e lëndëve nga lëmia civile në Gjykatën e Apelit për vitet 2021, 2022, ndërsa sa i përket lëndëve të tilla të vitit 2020, nevoja për rishpërndarjen e tyre të vlerësohet nga kryetari i gjykatës.
- II. Plani duhet të përmbaj adresimet konform diskutimeve të zhvilluara në takimin e KGJK-së të datës 7 mars 2024, dhe i njëjti duhet të dorëzohet në Këshill brenda afatit 15 ditor nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, në mënyrë që të prezantohet në takimin e radhës.
- III. Vendimi hyn në fuqi me datë 7 mars 2024.

A r s y e t i m

Këshilli Gjyqësor i Kosovës në takimin e datës 7 mars 2024, ka diskutuar lidhur me zbatimin e Planit Strategjik për Përmirësimin e Qasjes në Drejtësi në Gjykatën e Apelit. Pas shqyrtimit të kujdesshëm të ngarkesës me lëndë dhe objektivave të përshkruara në Planin Strategjik për Përmirësimin e Qasjes në Drejtësi, është parë e domosdoshme që kryetari së bashku me menaxhmentin e Gjykatës së Apelit, të ndërmarrin hapa proaktivë për të adresuar çështjen e balancimit të lëndëve.

Qëllimi i këtij rekomandimi është i dyfishtë, së pari të sigurohet trajtimi efikas i rasteve në Gjykatën e Apelit dhe së dyti të përmbushë objektivat e Planit Strategjik për Përmirësimin e Qasjes në Drejtësi, prandaj është thelbësore që një propozim i tillë për rishpërndarje të lëndëve t'i paraqitet Këshillit, ashtu siç është vendosur në dispozitiv të vendimit.

Albert ZOGAJ

Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës



Kopje e vendimit i dërgohet:

- Kryetarit të Gjykatës së Apelit;

Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, si dhe Apelit të KGJK-së